

Shënime Shpjeguese

A. Informacion i përgjithshëm

- Informacion për Shoqërinë :

Shoqëria është themeluar me datë 29.09.2016 dhe rregjistruar në QKB më datë 30.09.2016, me emrin ONYX, në formën ligjore SHPK, me NIPT L62130005H, adresa Farkë, Lagjja Sauk i Vjetër, tokë truall, Nr. Pasurie 22/4, Zonë kadastrale 3266, Vol 10, Tiranë.

Objekti i aktivitetit: Aktivitet në fushën e energjitikës, ndërtimit, transportit, mjedis, ujësjellës kanalizime. Import-Eksport, shitje me shumicë e pakicë, materiale elektrike, ndërtimi, industriale, hidroteknike, makineri e pajisje të çdo lloji etj.

Ortak i vetëm i shoqërisë, me 100 % pjesëmarrje është Z. Sahit Dollapi, njëkohësisht edhe Administrator i shoqërisë.

- Baza ligjore e hartimit të Pasqyrave Financiare (PF) :

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020 janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe duke u bazuar në Ligjin 9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Baza e përgatitjes së Pasqyrave Financiare: Mbi bazën e konceptit të materialitetit ;

Parimet bazë për përgatitjen e Pasqyrave Financiare :

1. Parimi i njësisë ekonomike: mban në llogaritë e saj aktivet, detyrimet dhe transaksionet ekonomike të veta ;
2. Parimi i vijimësisë : veprimtaria ekonomike e shoqërisë është e siguar të vazhdojë në të ardhmen duke mos pasur në plan ose nevojë ndërprerjen e aktivitetit të saj.
3. Kompensimi: midis një aktivi dhe një pasivi nuk ka, ndërsa midis të ardhurave dhe shpenzimeve ka vetëm në rastet që lejohen nga SKK.
4. Kuptueshmëria e Pasqyrave Financiare është realizuar në masën e plotë për të qënë të qarta dhe të kuptueshme për përdorues të jashtëm që kanë njohuri të përgjithshme të mjaftueshme në fushën e kontabilitetit.
5. Materialiteti është vlerësuar nga ana jonë dhe në bazë të tij PF janë hartuar vetëm për zëra materiale.
6. Besueshmëria për hartimin e PF është e siguar pasi nuk ka gabime materiale duke zbatuar parimet e mëposhtme:
 - Parimin e paraqitjes me besnikëri ;
 - Parimin e paanshmërisë pa asnjë influencim të qëllimshëm ;
 - Parimin e plotësisë duke paraqitur një pamje të vërtetë e të drejtë të PF ;
 - Parimin e qëndrueshmërisë për të mos ndryshuar politikat e metodat kontabël ;

- Parimin e krahasueshmërisë duke siguruar krahasimin midis dy periudhave ;
- Politikat kontabël

Për përcaktimin e kostos së inventarëve është zgjedhur metoda "FIFO" (hyrje e parë, dalje e parë. (SKK 4:)

Vlerësimi fillestar i një elementi të AAM që plotëson kriteret për njohje si aktiv në bilanc është vlerësuar me kosto. (SKK 5;)

Për vlerësimin e mëpasshëm të AAM është zgjedhur modeli i koston duke i paraqitur në bilanc me kosto minus amortizimin e akumuluar. (SKK 5;)

Për llogaritjen e amortizimit të AAM (SKK 5:) shoqëria ka përcaktuar metodën e shpërndarjes së vlerës së amortizueshme të një aktivi në bazë sistematike gjatë jetës së tij të dobishme, duke marrë parasysh: përdorimin e pritshëm të aktivitetit, konsumimin fizik të pritshëm, vjetërimin teknik ose tregtar dhe kufizimet ligjore apo të ngjashme.

Për llogaritjen e amortizimit sipas kësaj metode janë përcaktuar vitet e jetës së dobishme sipas aktiveve afatgjata materiale :

- Ndërtesa	40	vite jetë
- Instrumenta e vegla pune	3	vite jetë
- Mjete transporti furgon/kamionçinë	6	vite jetë
- Makineri e pajisje të tjera pune	6	vite jetë
- Mjete transporti kamiona/autobot	8	vite jetë
- Mjete transporti mjet teknologjik	10	vite jetë
- Mobileri e orendi	5	vite jetë
- Paisje informatike (kompj/fotok)	5	vite jetë

Aktivitet dhe detyrimet në monedhë të huaj janë rivlerësuar me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e fundit të periudhës tatimore, konkretisht :

- 1 Euro = 123.70 Lekë

B. Kuadri Kontabël i Aplikuar

Pasqyrat financiare të periudhës 1 Janar 2020 deri më 31 Dhjetor 2020 në përbërje të të cilave janë Bilanci, Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve, Pasqyra e Fluksit të Parasë, Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital në datat e mësipërme, janë përgatitur në bazë të kërkesave të Ligjit Nr 9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", nenet 4 deri 18 të këtij ligji dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të vendit tonë.

Bilanci në përbërje të pasqyrave financiare tregon pozicionin financiar (aktivet, pasivet dhe kapitalin) të Shoqërisë ONYX shpk më datë 31 Dhjetor 2020.

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve tregon performancën ekonomike (të ardhurat, shpenzimet dhe fitim/humbjen) të Shoqërisë për periudhën 1 Janar deri më 31 Dhjetor 2020.

Pasqyra e fluksit monetar tregon fluksin e parave (Arkëtimet dhe pagesat në para dhe ekuivalentët e saj) të Shoqërisë ONYX shpk për periudhën 1 Janar 2020 deri më 31 Dhjetor 2020.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital neto tregon ndryshimet në kapitalin e Shoqërisë ONYX shpk për periudhën 1 Janar 2020 deri më 31 Dhjetor 2020.

C. Politikat kryesore kontabël

Një përmbledhje e pjesës më të madhe të politikave kontabël të aplikuara në Pasqyrat Financiare janë si më poshtë:

1. Mjetet Monetare

Për Mjetet Monetare në arkë dhe në bankë është aplikuar politika kontabël e vlerësimit “Vlera e drejtë”, sipas paragrafit Nr 22 të SKK-së Nr 3.

Mjetet monetare në monedhë të huaj janë vlerësuar në monedhën bazë me kursin e Bankës së Shqipërisë datë 31 Dhjetor 2020.

2. Aktivet e tjera financiare afatshkurtra

Për Aktivet e Tjera Financiare Afatshkurtra të paraqitura në datën e mbylljes së bilancit më 31 Dhjetor 2020 është aplikuar politika kontabël e vlerësimit “Kosto historike minus zhvlerësimin e mundshëm”, sipas paragrafit Nr 26, 27 të SKK-së Nr 3. Për vitin aktual vlerësimi i tyre është bërë me vlerën nominale në krijim të tyre.

3. Inventari

Për Inventarin e paraqitur në datën e mbylljes së bilancit më 31 Dhjetor 2020 është aplikuar politika kontabël e vlerësimit “Kosto historike”, sipas paragrafit Nr 14, 15 të SKK-së Nr 4. Kostoja është llogaritur duke përdorur Metodën e Mesatares së Ponderuar.

4. Aktivet Afatgjata Materiale

- *Njohja dhe Matja:*

Vlerësimi fillestar i një elementi të AAM-vë që plotëson kriteret për njohje si aktiv në bilanc është vlerësuar me koston e marrjes ose të prodhimit të tyre. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për sjelljen e aktiveve në vendin dhe kushtet ekzistuese.

- *Njohja e Mëpasshme:*

AAM-të paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Nëse një pjesë e një elementi të AAM-së zëvendësohet, kostoja e pjesës së re i shtohet koston e elementit, nëse ajo përmbush kriteret e përkufizimit të AAM-së dhe kriteret e njohjes së aktiveve në bilanc. Pjesa e zëvendësuar do të hiqet nga bilanci edhe nëse ajo nuk është kontabilizuar si pjesë më vete. Nëse kostoja fillestare (rrjedhimisht, edhe vlera kontabël aktuale) e pjesës së zëvendësuar nuk dihet ajo mund të vlerësohet në bazë të koston aktuale të kësaj pjese minus amortizimin e vlerësuar.

- *Amortizimi Menaxherial :*

Për llogaritjen e amortizimit të AAM (SKK 5:) shoqëria ka përcaktuar metodën e shpërndarjes së vlerës së amortizueshme të një aktivi në bazë sistematike gjatë jetës së tij të dobishme.

Për llogaritjen e amortizimit sipas kësaj metode janë përcaktuar vitet e jetës së dobishme sipas aktivet afatgjata materiale :

– Ndërtesa	40	vite jetë
– Instrumenta e vegla pune	3	vite jetë
– Mjete transporti fugon/kamionçinë	6	vite jetë
– Makineri e pajisje të tjera pune	6	vite jetë
– Mjete transporti kamiona/autobot	8	vite jetë
– Mjete transporti mjet teknologjik	10	vite jetë
– Mobileri e orendi	5	vite jetë
– Paisje informatike (kompj/fotok)	5	vite jetë

- *Amortizimi Fiskal :*

Shoqëria në llogaritjen e vlerës së amortizimit për efekte të përcaktimit të detyrimeve tatimore, ka përdorur normat e amortizimit të përcaktuara në aktet ligjore, konkretisht :

Llojet e aktiveve të qëndrueshme	Normat e aplikuara	Metoda e aplikuar
Ndërtesa	5 %	Me vlerë të mbetur
Makineri dhe pajisje	20 %	Me vlerë të mbetur
Mjete transporti	20 %	Me vlerë të mbetur
Mobilje dhe orendi	20 %	Me vlerë të mbetur
Të tjera	20 %	Me vlerë të mbetur
Pajisje informatike	25 %	Me vlerë të mbetur

Llogaritja e amortizimit të AAM-ve të hyra gjatë vitit bëhet duke filluar nga data e parë e muajit pasardhës.

Tokat dhe Investimet në proces nuk amortizohen.

- **Çregjistrimi:**

Nje zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk pritet më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të ushtrimit.

- **Zhvlerësimi (Rënia në vlerë):**

Shoqëria nuk vlerëson në datën e raportimit nëse ka premisa që një aktiv të zhvlerësohet.

5. Aktivet Afatgjata Jo-materiale (AAJM-t)

Aktivët afatgjata jomateriale përfshijnë liçensat, të drejtat për përdorim dhe emri i mirë.

Njohja dhe Matja: Liçensat, të drejtat e përdorimit të cilat përftohen nga shoqëria paraqiten me kosto minus amotizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

Shpenzimet e Mëpasshme: Shpenzimet pasuese kapitalizohen vetëm në rastin kur shtojnë përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aktivin specifik me të cilat ato lidhen. Të gjitha shpenzimet njihen si fitim apo humbje në momentin kur kryhen.

Për Aktivet Afatgjate JoMateriale të paraqitura në datën e mbylljes së bilancit aplikohet politika kontabël e vlerësimit “Kosto historike minus amortizimin e akumuluar në vite”, sipas paragrafit Nr 22 të SKK-së Nr 5.

Amortizimi i AAJM është llogaritur sipas metodës të përcaktuar në Ligjin 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe normat e amortizimit janë si më poshtë:

– Të tjera aktive Afatgjata Jomateriale	10.00 %
---	---------

6. Huatë dhe parapagimet

Për Huatë dhe parapagimet të paraqitura në datën e mbylljes së bilancit me 31 Dhjetor 2020 është aplikuar politika kontabël e vlerësimit “Kosto historike minus zhvlerësimin e mundshëm”, sipas paragrafit Nr 32, 33 të SKK-së Nr 3. Për vitin aktual vlerësimi i tyre është bërë me vlerën nominale në krijim të tyre.

7. Huamarrje të tjera afatgjata

Për Huamarrjet e tjera Afatgjata të paraqitura në datën e mbylljes së bilancit me 31 Dhjetor 2020 është aplikuar politika kontabël e vlerësimit “Kosto historike minus zhvlerësimin e mundshëm”, sipas paragrafit Nr 32, 34 të SKK-së Nr 3.

8. Kapitali

Vlera e kapitaleve dhe përberësve të tij është vlerësuar me vlerën e tyre historike kontabël. Ndryshimet në grupin kapitale kanë ardhur jo si rezultat i ndonjë SKK-je.

9. Të Ardhurat dhe Shpenzimet

Vlerësimi i të Ardhurave dhe Shpenzimeve është bërë mbi bazën e parimit të konstatimit të drejtave dhe detyrimeve në momentin e ndodhjes. Vlerësimi i tyre është bërë sipas përcaktimeve në paragrafet 35-37 të SKK-së Nr 1 dhe të SKK-së Nr 8.

10. Konvertimi në Monedha të Huaja

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilin është kryer transaksioni. Aktivët dhe pasivët monetarë në monedhë të huaj në datën e mbylljes së bilancit janë rivlerësuar në monedhën funksionale sipas kursit të shpallur nga Banka e Shqipërisë në datën e mbylljes së periudhës ushtrimore. Diferencat që rrjedhin si rezultat i rikonvertimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi zyrtar i këmbimit, për monedhën e përdorur nga shoqëria, në konvertimin e gjendjeve të bilancit në monedhë të huaj në datën e hartimit të bilancit, është 1 Euro = 123.70 Lekë.

11. Krahuesshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kontabël Shqiptar. Të dhënat krahasuese pasqyrojnë gjendjen e pozicionit financiar të shoqërisë më 31 Dhjetor 2020.

12. Instrumentat Financiare

Instrumentat financiarë të shoqërisë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, likuiditete dhe vlera arke të tjera, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Njohja Fillestare

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit në fjalë. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin.

Instrumentat financiarë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç rasteve nëse përcaktohet ndryshe. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura.

Njohja e Meteishme

Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë maten siç përshkruhet më poshtë :

- *Paraja dhe Ekuivalentet*

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në bankat. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat dhe ato me një afat maturimi prej tre muajsh ose më pak që nga data fillestare. Likuiditetet dhe vlera arke të tjera maten më tej me fitim/ humbjet nga zhvlerësimet.

- *Llogari të Arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera nuk mbartin interes dhe paraqiten me vlerë nominale të pakësuar nga zbritjet e nevojshme për shuma që janë vlerësuar të pambledhshme. Vlerësimi i shumave të pambledhshme bazohet në gjykimin e Drejtimit.

- *Llogari të Pagueshme*

Llogaritë e pagueshme maten fillimisht me vlerën e tyre të drejtë (domethënë me kosto) dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

- *Huatë të Dhëna dhe të Marra*

Huatë e arkëtueshme (Huatë e dhëna), janë aktive financiare jo-derivative me pagesa të përcaktuara ose fikse dhe që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv. Pas matjes fillestare, të tilla aktive financiare maten në vazhdim me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv dhe duke zbritur rënien e vlerës. Kosto e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje ose shtesa të blerjes dhe tarifat ose kostot që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit (NEI). Efekti i tyre përfshihet në rezultatin financiar.

Huatë detyrime financiare (Huatë e marra), janë njohur fillimisht me vlerën e tregut neto nga kostot e transaksioneve dhe më pas njihen me vlerën e amortizuar. Shpenzimet e interesit të llogaritur me normën e interesit efektive (NEI) pasqyrohen në rezultat.

Norma e interesit efektive është norma që skanton saktësisht vlerat e ardhshme të parave gjatë viteve të planifikuara të detyrimit financiar ose kur është e përshtatshme, në një periudhë më të shkurtër.

Kostot e huamarrjes që lidhen drejtperdrejt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve kualifikuese, të cilat janë aktive që kërkojnë domosdoshmërisht një periudhë të madhe kohe për t'u bërë gati për përdorimin e tyre përfundimtar ose për shitje mund të shtohen kostos së këtyre aktiveve deri në momentin që këto aktive janë kryesisht gati për tu përdorur ose shitur.

- *Netimi i Instrumentave Financiare*

Aktivitet dhe pasivet financiare netohen dhe shuma neto e tyre raportohet në bilanc nëse, dhe vetëm nëse ka një të drejtë të detyrueshme ligjore për të netuar shumën e njohur dhe ekziston mundësia për të shlyer në shumën neto, apo për të realizuar aktivin dhe shlyer pasivet njëkohësisht.

- *Zhvlerësime të Aktiveve Financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet si i zhvlerësuar në ato raste kur ekzistojnë kushte objektive që tregojnë se një apo më shumë ngjarje (pas njohjes së tij fillestare) kanë efekte negative në flukset e ardhshme të parasë që parashikohet të burojnë prej atij aktivi. Vështirësitë e konsiderueshme financiare të debitorit, probabiliteti që debitori do të falimentojë apo një riorganizim financiar dhe pamundësia apo shkeljet në pagesa konsiderohen si tregues që një llogari e arkëtueshme është e zhvlerësuar.

- *Çregjistrimi*

Aktivitet financiare së bashku me fondin rezervë të zhvlerësimit çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet.

Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë përfundojnë, skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

- *Transaksionet me palët e lidhura*

Palë të lidhura janë ato, kur njëra prej palëve kontrollohet nga pala tjetër ose ka influencë të rëndësishme në vendimarrjen financiare ose të biznesit të palës tjetër.

13. Provigjionet

Provigjionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose të tërthortë) si rezultat i një ngjarjeje të shkuar për të cilën ka mundësi që të krijohen një rrjedhë burimesh të nevojshme për të përmbushur detyrimin dhe kur një përlllogaritje e besueshme e shumës së detyrimit mund të llogaritet. Provigjionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më mundësi për nevojën e një rrjedhe burimesh që përfshin përfitime ekonomike për shlyerjen e detyrimit, provigjionet rimerren. Provigjionet përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë njohur fillimisht.

Pasivet dhe aktivitet e kushtëzuara nuk njihen, por vetëm paraqiten në shënimet e pasqyrave financiare të ndërmjetme kur janë materiale.

14. Qiratë

Qiratë klasifikohen si qira financiare ose qira operative që në fillim të qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën me më të voglën midis vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të pagesave minimale të qirasë në datën e marrjes. Kosto financiare paraqet diferencën midis detyrimit total të qirasë dhe vlerës së drejtë të aktivitetit. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë kohëzgjatjes së qirasë me norma interesi të aplikueshme mbi balancën e mbetur të detyrimeve

15. Të Ardhurat dhe Shpenzimet

- *Të Ardhurat*

Të ardhurat njihen në masën që është e mundur që përfitime ekonomike do të hyjnë në Shoqëri dhe që të ardhurat mund të maten në mënyrë të besueshme, pavarësisht se kur bëhet pagesa. Të ardhura matet me vlerë të drejtë të mallit/shërbimit të shitur neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe zbritje të mundshme të shitjeve.

- *Shpenzimet*

Shoqëria njeh shpenzimet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në proporcion me kryerjen e tyre në datën e raportimit. Shpenzimet paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas natyrës së tyre, çka kërkon gjykim të konsiderueshëm nga drejtimi i Shoqërisë.

- *Të Ardhurat dhe Shpenzimet Financiare*

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur akumulohen, duke marrë parasysh metodën e interesit efektiv.

- *Tatimi mbi Fitimin*

Tatim fitimi apo humbjet e vitit përbëhet nga tatimi aktual. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si edhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

16. Dividentët

Shoqëria synon të njohë dividentët si detyrim në periudhën në të cilën janë deklaruar.

17. Kapitali i Vet

Kapitali i nënshkruar përfaqëson kontributin e ortakëve në datën e krijimit të shoqërisë dhe ndryshimet gjatë veprimtarisë.

Kapitali aksioner njihet me vlerën nominale.

18. Përfitimet e Punonjësve

▪ Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore që sigurojnë pension për punonjësit. Qeveria shqiptare është përgjegjëse për caktimin e minimumit të kontributit për sigurimet shoqërore në Shqipëri sipas një plani pensioni bazuar në kontribute. Kontributet e shoqërisë në planin e pensionit janë pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

19. Ngjarje pas mbylljes së Pasqyrave Financiare

Ngjarjet pas datës së bilancit që permbajnë informacion shtesë të Shoqërisë, në datën e Bilancit Kontabël (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në Pasqyrat Financiare. Ngjarjet pas bilancit që nuk janë ngjarje rregulluese paraqiten të shpalosura në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare kur janë materiale.

D. Informacion - Shtesë për zërat Materiale

Më poshtë informacioni është detajuar sipas pikave të shënimeve në PF :

I. Aktivët

1. Mjetet Monetare

Gjendja e mjeteve monetare në mbyllje të vitit tatimor 2020 dhe të vitit paraardhës 2019, paraqitet:

Balanca monetare në		Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
1.1	Banka	13,637,324	1,594,687
1.2	Arka	77,908	189,659
Shuma		13,715,232	1,784,346

Mjetet monetare janë paraqitur në bilanc sipas gjendjeve të llogarive bankare në datën e fundit të periudhës tatimore, më 31.12.2020, e cila është e njëjtë me balancat në dokumentet e lëvizjeve të bankave dhe me gjendjen e arkës së Shoqërisë në fund muajit Dhjetor 2020.

Në PF, gjendja monetare në valutë është paraqitur e vlerësuar me kursin e këmbimit në datën e fundit të periudhës tatimore sipas Bankës së Shqipërisë.

2. Investime. Shoqëria nuk ka investime financiare.

3. Të drejta të arkëtueshme.

Të arkëtueshmet nga Klientët në fund të periudhës tatimore 2020 dhe në 2019 janë :

Të arkëtueshme nga Klientë, Debitor etj		Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
3.1	Nga aktiviteti i shfrytëzimit	25,405,354	25,211,667
3.2	Nga njësitë ekonomike brenda grupit		
3.3	Njësitë ku ka interesa pjesëmarrëse		
3.4	Të tjera		131,782
3.5	Kapital i nënshkruar i papaguar		
Shuma		25,405,354	25,343,449

Në fund të periudhës 2020 shoqëria ka të drejta nga klientët nga kryerja e sipërmarrjes së investimit në vlerën 18,155 mijë lekë, nga kryerja e shërbimeve në sektorin hidroteknik dhe mjedis në vlerën 7,249 mijë lekë.

4. Inventarët

Gjendja e materialeve të konsumit në fund të periudhës tatimore 2020 dhe në 2019 janë :

Përshkrimi i llogarisë		Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
4.1	Lëndë e parë dhe materiale të konsumi	237,430	36,134,765
4.2	Prodhime në proçes dhe gjysëmprodukte		
4.3	Produkte të gatshme		
4.4	Mallra		
4.5	Aktive Biologjike		
4.6	AAGJM të mbajtura për shitje		
4.7	Parapagime për inventar	419,900	3,358,135
Shuma		657,330	39,492,900

Shoqëria ka materiale konsumi (karburant) gjendje në fund të periudhës tatimore në vlerën 237 mijë lekë.

Vlera e parapagimeve të inventarit në fund të periudhës tatimore 2020 i përket pagesave paradhënie për blerje materiale të tjera për investime në vlerën 419 mijë lekë.

5. Shpenzime të Shtyra

Në zërin e shpenzimeve të shtyra të periudhës tatimore 2020 përfshihet vlera prej 31 mijë lekë, vlerë e cila përbëhet nga shpenzimi për blerje të certifikatave për sistemin e menaxhimit të cilësisë, për sistemin e menaxhimit të mjedisit si dhe për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë me afat përdorimi 3 vjet, vlerë për tu shpërndarë në vitet pasardhëse. Vlera prej 31 mijë lekë është vlera e mbetur e shpenzimit për tu shpërndarë në vitet e mëpasshme.

Përshkrimi i llogarisë		Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
5	Shpenzime të shtyra	31,625	107,525

6. Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara.

Shoqëria nuk ka të evidentuar as në vitin e mbyllur 2020 dhe as në vitin paraardhës 2019 të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara.

7. Aktive Financiare. Shoqëria nuk ka aktive financiare.

8. Aktivet Materiale

Aktivët materiale në fund të periudhës tatimore 2020 dhe në 2019 paraqiten si më poshtë :

Përshkrimi i llogarisë		Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
8.3	Toka		
8.3	Ndertesa	51,796,241	13,959,064
8.3	Të tjera Instalime dhe pajisje	18,126,529	23,211,528
8.4	Parapagime për aktive materiale e në proces	10,534,008	46,825,826
Shuma		80,456,778	83,996,418

Shoqëria gjatë vitit 2020, ka kaluar në përdorim (tek Të tjera instalime dhe pajisje) aktive materiale të qëndrueshme si vegla pune, përkatësisht në vlerën 17 mijë lekë, në vlerën 1,107 mijë lekë për mjete transporti dhe 1,046 mijë lekë për makineri e pajisje të tjera pune dhe ndertesa në vlerën 38,764 leke.

Tek posti Parapagime dhe në process, janë evidentuar blerja e aktiveve materiale dhe e shpenzimeve për llogari të tyre të cilat akoma nuk janë vënë në punë, në vlerën 10,534 mijë lekë.

9. Aktivet Biologjike. Shoqëria nuk ka aktive biologjike.

10. Aktive jo materiale. Shoqëria nuk ka aktive jomateriale.

11. Aktive tatimore të shtyra. Shoqëria nuk ka aktive tatimore të shtyra.

12. Kapitali i nënshkruar i papaguar. Shoqëria nuk ka kapital të nënshkruar të papaguar.

II. Detyrimet dhe Kapitali

13. Detyrimet Afatshkurtra

Detyrimet e shoqërisë në fund të periudhës tatimore 2020 dhe në 2019 paraqiten si më poshtë:

Detyrimet Afatshkurtra		Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
13.1	Titujt e huamarrjes	51,549,703	79,925,577
13.2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë		
13.3	Arkëtime në avancë për porosi		18,287,708
13.4	Të pagueshme për aktive të shfrytëzimit	15,733,544	38,282,795
13.5	Dëftesa të pagueshme		
13.6	Të pagueshme ndaj njësive brenda grupit		
13.7	Të pagueshme ku ka interesa pjesëmarr		
13.8	Ndaj punonjësve dhe sig shoq/shënd	2,900,912	3,268,877
13.9	Të pagueshme për detyrimet tatimore	4,256,620	(2,843,853)
13.13	Të tjera të pagueshme		
Shuma		74,440,780	136,921,104

Në postin Titujt e huamarrjes, janë evidentuar detyrimet ndaj Pronarit për vlerën 48,207 mijë lekë për derdhjet monetare në llogari për shërbimin e biznesit, si edhe detyrime ndaj individëve të tjerë në vlerën 3,341 mijë lekë, detyrime huamarrje pa interesa e pagesa shtesë për kthimin e tyre.

Po kështu, tek detyrimet afatshkurtra, janë evidentuar detyrime dieta ndaj punonjësve të papaguara gjatë vitit tatimor 2019 dhe 2020 në vlerën 2,000 mijë lekë.

Tek detyrimet tatimore, janë shënuar detyrimi për TVSH-në, Sig. Shoq & Shënd dhe TAP, Tatimi në Burim si dhe detyrimi për Tatim Fitimin, të cilat i përkasin deklarimeve të periudhës mujore të fundit të vitit tatimorë.

14. Të pagueshme për shpenzime të konstatuara.

Në fund të periudhës tatimore 2020 shoqëria nuk ka të evidentuar në PF detyrime për shpenzime të konstatuara.

Detyrimet Afatshkurtra		Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
14	Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		48,586

15. Të ardhura të shtyra. Shoqëria nuk ka detyrime për ardhura të shtyra në fund të periudhës tatimore 2020.

16. Provizione. Shoqëria nuk ka detyrime për provizione.

17. Detyrimet Afatgjata

Detyrimet afatgjatë e shoqërisë në fund të periudhës tatimore 2020 dhe në 2019 paraqiten si më poshtë :

Detyrimet afatgjata:		Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
17.1	Titujt e huamarrjes	0	0
17.2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	11,792,173	0
17.3	Arkëtimet në avancë për porosi	0	0
17.4	Të pagueshme aktivitetin e shfrytëzimit	0	0
17.5	Dëftesa të pagueshme	0	0
17.6	Të pagueshme brenda grupit	0	0
17.7	Të pagueshme ku ka interesa pjesëmarrëse	0	0
17.8	Të tjera të pagueshme	0	0
Shuma		11,792,173	0

Shoqëria ka të evidentuar detyrime afatgjatë në fund të viti tatimor në vlerën prej 11,792 ndaj institucioneve të kredisë.

18. **Të pagueshme për shpenzime të konstatuara.** Shoqëria nuk ka detyrime afatgjata për shpenzime të konstatuara.
19. **Të ardhura të shtyra.** Shoqëria nuk ka detyrime afatgjata për të ardhura të shtyra.
20. **Provizionet.** Shoqëria nuk ka detyrime për provizione.
21. **Detyrime tatimore të shtyra.** Shoqëria nuk ka detyrime tatimore të shtyra.
22. **Kapitali dhe Rezervat.** Shoqëria nuk ka të dhëna në PF për këtë post.
23. **Kapitali I Nënshkruar.** Vlera e Kapitalit të nënshkruar dhe të paguar është 100,000 lekë, në periudhën tatimore 2020 dhe në vitin paraardhës 2019.
24. **Primi i lidhur me kapitalin.** Shoqëria nuk ka të dhëna në PF për këtë post.
25. **Rezerva rivlerësimi.** Shoqëria nuk ka të dhëna në PF për këtë post.
26. **Rezervat e Tjera.** Shoqëria në fund të vitit paraardhës ishte me fitim. Me miratimin e PF dhe shpërndarjen e fitimit të vitit paraardhës iu shtua fondit të rezervave të tjera vlera prej 6,947,932 lekë.
27. **Fitimi i pashpërndarë.** Shoqëria nuk ka fitim të pashpërndarë në fund të periudhës tatimore 2020.
28. **Fitim / Humbja e Vitit.** Vlera e fitimit të vitit të mbyllur 2020 është 20,278,418 lekë përkundër vitit paraardhës ku shoqëria rezultoi me fitim 6,947,932 lekë.

III. Të Ardhurat dhe Shpenzimet

29. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit.

Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit		Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
29	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	130,057,230	43,412,122
Shuma		130,057,230	43,412,122

Në vitin tatimor të mbyllur, shoqëria ka realizuar të ardhura nga shitja e shërbimeve në vlerën 130,057 mijë Lekë, këto nga aktiviteti i saj, kryesisht në fushën e sipërmarrjes së ndërtimit në sektorin elektrik në 50 % të të ardhurave, në fushën e monitorimit të mjedisit 1 %, në fushën e shitjeve të aktiveve afatgjata 10 %, në fushën e qerave të ambientit dhe mjeteve të transportit 5 %, në fushën e shërbimeve të sektorit hidro 15 % dhe të tjera 19 %.

30. Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhim në proces. Shoqëria nuk ka evidentuar të dhëna në këtë post të PF as në periudhën tatimore 2020 dhe as në vitin paraardhës 2019.

31. Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar. Shoqëria nuk ka evidentuar të dhëna në këtë post të PF as në periudhën tatimore 2020 dhe as në vitin paraardhës 2019.

32. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit. Shoqëria nuk ka evidentuar të dhëna në këtë post të PF as periudhën tatimore 2020 dhe as në vitin paraardhës 2019.

33. Shpenzimet për lëndë të parë dhe materiale.

Evidentimi i shpenzimeve materiale është si vijon :

Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
33.1	Lënda e parë dhe materiale të konsumi	46,228,977	7,392,578
33.2	Të tjera shpenzime	985,836	202,005
Shuma		47,214,813	7,594,583

Në këtë post të PF për periudhën tatimore 2019 janë evidentuar shpenzimet për karburant, vlera 2,278 mijë lekë dhe shpenzime për blerjen e lëndëve të para për kryerjen e investimeve dhe materiale konsumi vlera 43,950 mijë lekë, këto për nevoja të aktivitetit të biznesit të shoqërisë.

34. Shpenzime të personelit

Shpenzimet për punonjësit, pagat, shpërblimet, sigurimet janë si më poshtë :

Shpenzime të personelit		Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
34.1	Paga dhe shpërblime	7,618,861	9,017,964
34.2	Shpenzime të sigurimeve shoq/shënd	1,265,547	1,465,644
Shuma		8,884,408	10,483,608

Gjatë vitit tatimor 2020, shoqëria ka pasur punonjës të punësuar sipas periudhave të kërkesës së angazhimeve të biznesit.

Pagat e punonjësve dhe detyrimet tatimore për ata janë llogaritur sipas akteve ligjore përkatëse dhe janë paguar rregullisht në bankë.

Shpenzimet për paga janë në vlerën 7,618 mijë lekë, dhe shpenzime të sigurimeve janë në vlerën 1,265 mijë lekë.

35. Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata material. Shoqëria nuk ka evidentuar të dhëna në këtë post të PF as në periudhën tatimore 2020 dhe as në vitin paraardhës 2019.

36. Shpenzime konsumi dhe amortizimi. Shpenzimet e amortizimit paraqiten:

Shpenzime konsumi dhe amortizimi		Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
36	Shpenzime amortizimi	5,342,935	1,802,961
Shuma		5,342,935	1,802,961

Të dhëna për amortizimin e Aktiveve Afatgjata Materiale dhe Aktiveve Afatgjata Jomateriale, të llogaritur në 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018, janë si më poshtë :

Amortizimi i llogaritur	Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
Amortizimi AAJM - menaxherial	0	0
Amortizimi AAM - menaxherial	5,342,935	3,697,238
Total Amortizim Menaxherial	5,342,935	3,697,238
Amortizimi AAJM - Fiskal	0	0
Amortizimi AAM - Fiskal	6,145,223	4,558,363
Total Amortizim Fiskal	6,145,223	4,558,363
Diferenca Menaxherial - Fiskal	(802,288)	(861,124)

Këtu është evidentuar shpenzimi për amortizimin e aktiveve të qëndrueshme materiale.

Shoqëria ka bërë llogaritjen e amortizimit bazuar në vitet e jetës së përdorimit të aktiveve (amortizim menaxherial) dhe llogaritjen sipas normave fiskale ligjore (amortizim fiskal).

Vlera 5,342 mijë lekë është shuma e amortizimit menaxherial llogaritur në vitin 2020, përkatësisht për Instrumenta e vegla vlera 136 mijë lekë, për mjete transporti vlera 2,686 mijë lekë, makineri e pajisje te tjera vlera 1,238 mobileri e orendi vlera 187 mijë lekë, pajisje kompjuterike 166 mijë lekë dhe ndërtesa 927 mijë lekë.

Vlera e amortizimit fiskal për këto aktive, në vitin tatimor 2020, është vlera 6,145 mijë, vlerë e cila është njohur në shpenzimet tatimore.

37. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Shpenzime të tjera shfrytëzimi		Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
37	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	43,950,178	13,482,654
	Shuma	43,950,178	13,482,654

Në këtë post të shpenzimeve janë evidentuar shpenzimet e blerjes së shërbimeve nga të tretët, për aktivitetin e shoqërisë në vlerën 27,758 mijë lekë, vlera kontabël e automjeteve të shitura në vlerën 6,793 mijë lekë, shpenzimet për dietat e punonjësve në vlerën 2,065 mijë lekë, shpenzime qiraje për ambientet e ushtrimit të aktivitetit në vlerën 1,175 lekë, shpenzime mirembajtje dhe riparime mjete në vlerën 1,778 leke si dhe shpenzime të tjera në vlerën 4,381 mijë lekë.

38. Të ardhura të tjera. Shoqëria nuk ka evidentuar të dhëna në këtë post të PF as në periudhën tatimore 2020 dhe as në vitin paraardhës 2019.

39. Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra. Shoqëria nuk ka evidentuar të dhëna në këtë post të PF as në periudhën tatimore 2020 dhe as në vitin paraardhës 2019.

40. Shpenzime financiare.

Shpenzime financiare		Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
40.1	Shpenzime interesi dhe shpenz te ngjashme	406,430	
40.2	Shpenzime të tjera financiare	520,277	(21,423)
	Shuma	926,707	(21,423)

Tek shpenzimet financiare, treguesi në vitin tatimor 2020 është "shpenzim" ashtu si edhe në vitin paraardhës.

27. Menaxhimi i kapitalit

Një nga qëllimet kryesore të Shoqërisë mbetet ruajtja e një prirjeje pozitive dhe për të përmirësuar përfitimet e Shoqërisë, jo vetëm për mbështetjen e planeve të investimeve, por edhe për konsolidimin e mëtejshëm dhe stabilizimin e strukturës së kapitalit në vitet në vijim.

Të dhënat për strukturën e Kapitalit në fund të vitit tatimor 2020 dhe 2019, janë :

	Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
Totali i borxhit afatgjatë	11,792,173	0
Totali i huasë afatashkurtër	51,549,703	79,925,577
Totali i borxhit	63,341,876	79,925,577
Më Pak: Aktive Monetare	(13,715,232)	(1,784,346)
Totali i borxhit, neto	49,626,644	78,141,231
Humbja përpara tatimit mbi fitimin dhe të ardhurave të tjera (Shpenzime)	23,738,189	8,175,462
Plus: Zhvlerësimi dhe amortizimi	5,342,935	3,697,238
Humbja para Interesave, tatimit mbi fitimin, zhvlerësimit dhe amortizimit	29,081,124	11,872,700
Kapitali Aksioner total	34,033,366	13,754,948
Borxhi total	63,341,876	79,925,577
Kapitali total	97,375,242	93,680,525
Raporti Borxhi/Kapital	65,05 %	85,32 %

VI. Fitimi i periudhës tatimore

Treguesi i TF dhe llogaritja e tij në periudhën tatimore 2020 dhe në 2019 paraqiten si më poshtë:

1		Të Ardhurat		43,412,122
	30	Nga Shitjet	130,057,230	43,366,760
	30-33	Të ardhura të tjera		45,362
2		Kostot e Shitjeve		35,258,083
	33	Lënda e parë dhe materiale	46,228,977	7,594,583
	34	Shpenzime të personelit	8,884,408	10,483,608
	36	Shpenzime amortizimi	5,342,935	3,697,238
	37	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	43,950,178	13,482,654
3=1-2		Fitimi nga veprimtaria	24,664,896	8,154,039
4	40	Shpenzime Financiare	926,707	(21,423)
5=3-4	42	Fitimi bruto	23,738,189	8,175,462

Shoqëria në vitin tatimor 2019 ka rezultat tatimor pozitiv në vlerën 23,738 mijë lekë.

Vlera e shpenzimeve, që sipas akteve ligjore konsiderohen të panjohura për llogaritjen e detyrimit tatimor, janë si më poshtë sipas natyrës së tyre dhe llogarisë kontabël:

Llogaria	Përshkrimi i Shpenzimeve	Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
6041	Shpenzime për energji elektrike		
6042	Shpenzime Uji	1,650	15,200
618	Shpenzime blerje të ndryshme	45,955	169,150
625	Shpenzime mirembajtje dhe riparime	18,235	411,694
626	Shpenzime Internet, telef, postë		
641	Shpenzime Pagat e personelit		121,444
644	Shpenzime Sig Shoq e Shënd		
657	Penalitete, gjoba, dëmshpërbl	63,400	151,710
681	Shpenzime Amort AQT	(802,286)	(861,124)
Shuma		(673,048)	8,073

Vlera e shpenzimeve që i shtohen fitimit para tatimit, është vlerë një vlere negative prej 673 mijë lekë, e cila vjen si rezultat i differences negative prej 802 mije leke te shpenzimit për amortizimin e aktiveve të qëndrueshme materiale te shpjeguar ne piken 36.

Duke vazhduar tabelën e llogaritjes së TF, me numrin 6 shpenzimet e panjohura, kemi:

6		Shpenzime të panjohura	(673,048)	8,073
7=5+6		Vlera e Fitimit të Tatueshëm	23,065,141	8,183,535
8=7*15%	43	Tatim Fitimi 15 %	3,459,771	1,227,530
9=5-8		Fitimi/Humbja neto e vitit	20,278,418	6,947,932
10=8/7		Norma efektive e TF	14,57 %	15.01 %

Në përfundim, treguesi i detyrimit tatimor për Tatimin mbi Fitimin në vitin tatimor 2020, rezulton të jetë 3,459 mijë lekë.

Fitimi neto i vitit rezulton vlere 20,278 mijë lekë.

Llogaritë jashtë bilancit

Shoqëria nuk ka llogari jashtë bilancit.

Shënime të tjera shpjeguese

Ngjarje të ndodhura pas datës së bilancit për të cilat bëhen rregullime apo ngjarje të ndodhura pas datës së bilancit për të cilat nuk bëhen rregullime nuk ka.

Gabime materiale të ndodhura në periudhat kontabël të mëparshme të konstatuara gjatë periudhës tatimore të mbyllur më 31 Dhjetor 2020 dhe që është bërë korigjim nuk ka.

Edlira Kurti

